



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. ____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

VENDIM
Nr. 534, datë 12.10.2023

PËR
PËRFUNDIMIN E KOHËZGJATJES SË KOMANDIMIT TË GJYQTARES
ZNJ. {...} NË POZICIONIN NDIHMËSMAGJISTRATE NË GJYKATËN E LARTË

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenin 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 435, datë 14.10.2023 “Për komandimin e znj. {...} në pozicionin e “ndihmësmagjistratit”, në Gjykatën e Lartë” me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përfundimin e kohëzgjatjes së komandimit të gjyqtares znj. {...} në pozicionin e e “ndihmësmagjistratit”, në Gjykatën e Lartë në fund të afatit të komandimit, më datë 20.10.2023.
2. Kthimin e gjyqtares znj. {...} në pozicionin e mëparshëm në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. {...} sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në adresën postare elektronike zyrtare, si edhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR